


	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		Page1
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

Raporti i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) të KOSTT-it viti 2019

	Përgatit	Kontrolli	Aprovoi
Emri Mbiemri Pozita	Mimoza Byqmeti Zyrtare Ligjore / Zyrtare për Pajtueshmëri	Visar Hoxha Sekretar i Kompanisë/Menaxher i Zyrës Ligjore	Ilir Shala Kryeshef Ekzekutiv
Nënshkrimi			
Data	Janar 2020	28 Janar 2020	30 Janar 2020



	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page2</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. Ndërmarrja	4
2. Programi i Pajtueshmërisë	4
3.Pronësia e sistemit të transmetimit	4
4.Kontrolli dhe pronësia e KOSTT si OST.....	5
5.Pavarësia e Bordit të KOSTT	5
6.Pavarësia financiare e KOSTT	5
7.Përshtatshmëria e burimeve njerëzore	6
8.Qasja jodiskriminuese në sistemin e transmetimit (konfidencialiteti i të dhënave).....	7
9.Trajnimi	7
10.Informacionet e ofruara nga KOSTT për personat që ushtrojnë kontroll mbi KEK SH.A./Ibër Lepenc SH.A.	7
11.Detyrat e OST-së	8
12.Vonesa ose braktisja e investimeve të planifikuara	9
Projektet e fazës së VI dhe VII - KfW	11
ID 053 Furnizim me 20 copë pajisje Meter Data Collection për nënstacionet distributive 110/x kV	12
ID 055 Rehabilitimi i NS Prishtina 2 dhe NS Deqani (Ndërrimi I ndarësve 110kV).....	12
13.Dividenda.....	12
14.Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë	12
Konkluzion	13

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		Page 3
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

Hyrje

Operatori i Sistemit të Transmetimit (KOSTT) ka hartuar këtë Raport të Pajtueshmërisë në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Direktivës Nr. 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me Rregullat e përbashkëta për Tregjet e Brendshme për Energji Elektrike e datës 13 korrik 2009, dhe nenit 21 të Rregullës për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, Rregulla ZRRE/Nr. 14/2017 (prill 2017), e cila e obligon OST-në që ta hartoj atë dhe ta dorëzoj të njëjtin pranë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për miratim.

Me 15 shkurt 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) ka nxjerr vendimin me nr.V_1107_2019 për miratimin përfundimtar të Certifikimit të KOSTT sh.a. si OST.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ka caktuar znj. Mimoza Byqmeti në detyrën e Zyrtares për Pajtueshmëri (këtu e tutje referuar si Zyrtari për Pajtueshmëri), e miratuar nga Rregullatori me Vendimin V_1186_2019) të datës 14 tetor 2019.

Ky raport hartohet bazuar në detyrat e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të cilat rrjedhin nga Programi i Pajtueshmërisë, i miratuar me vendim të Bordit të ZRRE-se nr.V_1203_2019 me datë 27 nëntor 2019.

Ky është raporti i parë i pajtueshmërisë i cili bëhet pas certifikimit të KOSTT sh.a. si OST, për vitin 2019 dhe përshkruan masat e ndërmarra nga KOSTT për të implementuar programin e pajtueshmërisë për periudhën 15 shkurt -31dhjetor 2019 me qëllim të sigurimit të operimit të pavarur të rrjetit të transmetimit të Kosovës, dhe pajtueshmërinë me vendimin përfundimtar për certifikim, të nxjerrë nga Rregullatori.

Lidhur me hartimin e këtij raporti Zyrtari i Pajtueshmërisë është mbështetur me informacionin e nevojshëm nga Departamentet përkatëse të OST-së, sipas funksioneve që kryejnë siç janë: Operatori i Transmetimit, Operatori i Sistemit, Operatori i Tregut, Financat dhe Thesari, Prokurimi, Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve, Çështjet Rregullative dhe Tarifat, Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Përkrahëse.

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		Page 4
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

1. Ndërmarrja

KOSTT sh.a është Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Programi i Pajtueshmërisë

Programi i Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit i miratuar nga Bordi i ZRRE-së me vendimin nr.V_1203_2019 me datë 27 nëntor 2019, paraqet një program i cili përcakton masat të cilat duhen të ndërmerren me qëllim të parandalimit të çfarëdo trajtimi diskriminues, aplikimin e masave të nevojshme për të monitoruar pajtueshmërinë e vazhdueshme të operatorit të sistemit të transmetimit me programin e pajtueshmërisë.

3. Pronësia e sistemit të transmetimit

KOSTT ka në pronësi dhe operon sistemin e transmetimit në Republikën e Kosovës duke përfshirë edhe interkonektorët me Serbinë, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi deri te pikat interkonektuese.

KOSTT ka në pronësi asetet e mëposhtme që janë pjesë e ndërlidhjeve elektrike midis sistemit të transmetimit të Kosovës dhe sistemeve të transmetimit të vendeve fqinje:

- a. Qarku i dyfishtë LP400kV, nr. 407, 40.049 km SS Kosova B në SS Nish (Serbi)
- b. Qarku i dyfishtë LP 400kV, nr. 420/2, 30.51 km SS Ferizaj deri NS Shkup (Maqedoni)
- c. Qarku i dyfishtë LP 400kV, nr. 437/2, 28.709 km SS Peja deri në SS Ribarevine (Mali i Zi)
- d. Qarku i dyfishtë LP 400kV, 85.5 km SS Kosova B në NS Kashar (Shqipëri)
- e. Qarku i dyfishtë LP 220kV, nr. 2303, 45.05 km NS Prizren-2 deri në SS Fierzë (Shqipëri)
- f. Qarku i dyfishtë LP 220kV, nr. 205/2, 14.648 km SS Besiana në SS Krushevc (Serbia)
- g. Qarku i dyfishtë LP 110kV, nr. 1140, 10.81 km NS Berivojcë deri në NS Bujanovc (Serbi)
- h. Qarku i dyfishtë LP 110kV, nr. 155, 18.78 km SS Vallaqë deri në SS N. Pazar (Serbi)

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 5</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

4. Kontrolli dhe pronësia e KOSTT si OST

KOSTT sh.a. është ndërmarrje publike ku:

- a) Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni i vetëm që kontrollon OST-në me kompetenca ekskluzive për të ushtruar të drejtat e aksionarit, të emëroj dhe shkarkoj Bordin e Drejtorëve duke përjashtuar Kryeshefin Ekzekutiv dhe caktimin e pagesës (kompensimit) të Bordit të Drejtorëve. Komiteti i Auditimit të OST-së po ashtu emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- b) Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ushtron kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në asnjë ndërmarrje tjetër aktive në tregun e raportueshëm.
- c) Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka të drejta mbi çfarëdo ndërmarrje tjetër në tregun e raportueshëm (KEK sh.a. dhe Ibër Lepenci sh.a.) as në personin që ushtron të drejtat e aksionarit në lidhje me këto ndërmarrje.

5. Pavarësia e Bordit të KOSTT

KOSTT nuk ka Bord të Drejtorëve të emëruar që nga 2 shtatori 2018, që nënkupton se për tërë periudhën kohore të raportimit që nga certifikimi i KOSTT-it si OST, KOSTT funksionon pa Bord të Drejtorëve. Vlen të ceket se menaxhmenti i KOSTT-it në mënyrë formale ka kërkuar disa herë nga Aksionari që të ndërmerren të gjitha masat për emërimin e Bordit të Drejtorëve, duke tërhequr vërejtjen për mungesën e miratimit të Buxhetit dhe Planit të Biznesit, por pa ndonjë rezultat.

6. Pavarësia financiare e KOSTT

KOSTT ka pavarësinë financiare për të miratuar shpenzimet e nevojshme dhe ka demonstruar një historik të investimeve kapitale për sistemin e operimeve, mirëmbajtje dhe zhvillim. KOSTT ka qasje në institucionet financiare ndërkombëtare për të financuar investimet kapitale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit në dy mënyra:

- a. përmes marrëveshjeve trepalëshe të huas ndërkombëtare me institucionet financiare ndërkombëtare; dhe
- b. përmes marrëveshjeve dypalëshe me bankat tregtare

KOSTT nuk merr ndonjë mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës. OST mirëmban llogari të ndara sipas kërkesave rregullative për aktivitetet e ndryshme të licencuara.

	Raporti i i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Page 6</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

7. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore

KOSTT sh.a. ka stafin e nevojshëm për shpërndarje të plotë dhe në mënyrë efektive të të gjitha obligimeve në kuptim edhe të një kompanie të themeluar sipas Ligjit për shoqëri aksionare si dhe në atë të punës. Në bazë të Direktivës Nr. 2009/72 / EC, neni 9 (1) (a) OST - KOSTT duhet të jetë në gjendje "të veprojë si Operator i Sistemit të Transmetimit" siç përcaktohet në nenin 2 pika 4 e Direktivës, dhe duhet të ketë " burime njerëzore, teknike dhe financiare " në mënyrë që të kryej funksionet e OST-së. Parime dhe kërkesa të tilla sanksionohen edhe me nenin 16.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili përcakton se "Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për funksionimin e sigurt, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të transmetimit. "Në funksion të shtjellimeve të mësipërme, ne konsiderojmë se neni 27 i Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik në Kosovë, përfshirë KOSTT, shkel direkt pavarësinë financiare të KOSTT në përcaktimin e pagave të të gjithë punonjësve të KOSTT, gjë që kufizon disponueshmërinë e burimeve njerëzore për të përmbushur ligjin dhe detyrimet, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe detyrimet e Republikës së Kosovës me marrëveshje ndërkombëtare. KOSTT kërkon një personel më të kualifikuar se kompanitë e tjera në sektorin e energjisë elektrike për shkak të faktit që personeli i KOSTT duhet të ndër veprojë vazhdimisht me vendimmarrësit evropianë (palët dhe rregullatorët OST-të); Personeli i KOSTT duhet të jetë në gjendje të përcjellë pozicionet e KOSTT dhe të jetë në gjendje të argumentojë qëndrime të tilla pa mbështetje të jashtme.

Sa i përket rolit të ardhshëm të KOSTT si një OST plotësisht i pavarur, nevoja që KOSTT të jetë koherent me përpjekjet në rritje në nivelin ndërkombëtar kërkohen njohuri më të gjera të standardeve dhe procedurave ndërkombëtare që do të aplikohen në sistemin e transmetimit të Kosovës, duke rritur më tej kërkesat e personelit të kompanisë për të operuar ndërkombëtarisht (menaxherë dhe punonjës shumë të arsimuar). Prandaj, KOSTT shpreh shqetësim serioz se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga, KOSTT do të përballet me ikje të trurit, e cila do të paraqiste vështirësi të patejkalueshme për funksionimin normal dhe do të bëhej pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës së transmetimit dhe tregut të energjisë elektrike.

Është e rëndësishme të theksohet se KOSTT kishte kërkuar nga Ombudspersoni i Kosovës që të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Siç dihet tashmë, me kërkesë të Ombudspersonit i njëjti aktualisht është pezulluar respektivisht Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për masë të përkohshme deri me 30 mars 2020.

	Raporti i i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Page 7</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

8. Qasja jodiskriminuëse në sistemin e transmetimit (konfidencialiteti i të dhënave)

OST e KOSTT në pajtuëshmëri me Ligjin për Energjinë Elektrike ka zhvilluar Kodin e Rrjetit i cili është miratuar nga ZRrE në atë mënyrë që të sigurojë mosdiskriminim dhe transparencë në sigurimin e qasjes së palëve të treta në sistem. KOSTT gjithashtu zbaton Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin Transmetues, dhe një varg procedurash të ndërlidhura të cilat i ofrojnë qasje transparente dhe jo diskriminuëse për palët të cilat kërkojnë të kyçin infrastrukturën në rrjetin transmetues të KOSTT. Në vitin 2019 KOSTT ka nënshkruar një Marrëveshje të Kyçjes me BOND COM ENERGY POINT sh.p.k. Parku Energjetik me Erë "BUDAKOVA".

9. Trajnimi

KOSTT është në fazën fillestare të ngritjes së vetëdijes dhe sensibilizimit të stafit sa i përket çështjes së pajtuëshmërisë dhe njëkohësisht identifikimit të nevojave për përfshirjen e stafit të nevojshëm në trajnim. KOSTT është i vetëdijshëm se njohuritë e stafit rreth pajtuëshmërisë shturëse janë të një rëndësie të veçantë për procesin e vlerësimit vjetor dhe sigurimin e pajtuëshmërisë andaj edhe ndërmarrja e masave respektivisht organizimi i trajnimeve në këtë fushë është më se i nevojshëm. Në këtë kontekst gjatë intervistimit të stafit përkatës lidhur me pajtuëshmërinë është arritur të bëhet edhe identifikimi i nevojave konkrete lidhur me trajnimet të cilat do të adresohen përshtatshëm tek personat përgjegjës.

10. Informacionet e ofruara nga KOSTT për personat që ushtrojnë kontroll mbi KEK SH.A./Ibër Lepenc SH.A.

Nga KOSTT, sipas legjislacionit të Kosovës, kërkohet që të bëjë disa parashtrës/raportime rutinore, vjetore pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për qëllime informative dhe në rrethana të caktuara të kufizuara pranë Ministrisë së Financave. Që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Energji Elektrike dhe certifikimit, nga KOSTT nuk është kërkuar të paraqet ndonjë informacion në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik ose Ministrinë e Financave.

KOSTT ka kontakte dhe takime të rregullta me aktorët e sektorit të energjisë elektrike. Kështu që janë mbajtur një seri takimesh që synojnë koordinimin e aktiviteteve në nivel sektorial dhe lidhur me zbatimin e Strategjisë së Energjisë me MED, ZRRE, KEDS, KESCO dhe palë të tjera.

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		Page 8
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

KOSTT ka mbajtur kontakte të rregullta me Qeverinë dhe aktorët e tjerë me qëllim të informimit dhe koordinimit të aktiviteteve

11. Detyrat e OST-së

Ligjet e Kosovës për energjinë, dhe kryesisht Neni 16 i Ligjit për Energjinë Elektrike, kanë të transpozuar, plotësisht dispozitat e Direktivës 2009/72/KE në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e OST-së. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit dhe Transmetimit (OST) është përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes, dhe nëse është i nevojshëm për zhvillimin e rrjetit të transmetimit në zona të caktuara. Po kështu, ai është përgjegjës për ndërlidhjen e rrjetit me rrjetet e tjera si dhe për sigurimin afatgjatë të aftësisë së sistemit për të përballuar kërkesat e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë i ka dhënë KOSTT-it sh.a, licencën si Operator i Sistemit të Transmetimit, licencë kjo e cila ka hyrë në fuqi më 4 tetor 2006.

Operatori i Sistemit të Transmetimit menaxhon dhe operon me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës si dhe është përgjegjës për transmetimin e energjisë elektrike në rrjetet kryesore të tensionit të lartë.

Operatori i Sistemit dhe Transmetimit të Kosovës:

- Vepron në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Rrjetit Elektrik, Kodit Matës dhe Kodit të Shpërndarjes
- Siguron qasje jodiskriminuese për shfrytëzuesit dhe u siguron atyre informata të nevojshme për një qasje efikase në sistem
- Përcakton të tilla tarifa dhe pagesa për lidhje dhe shfrytëzim të sistemit që të nxisin konkurrencën në sektorin e energjisë si dhe të lehtësojnë hyrjen e subjekteve të reja në treg.

KOSTT thekson se për arsye që janë jashtë kontrollit të saj nuk është në gjendje të kryej alokimin e kapaciteteve të tij të transmetimit ndërlidhës. Gatishmëria aktuale e KOSTT për të kryer këtë detyrë, pasi u bë një zonë kontrolli, u vërtetua duke përmbytur të gjitha testimet teknike të kërkuara nga ENTSO-E, siç tregohet në raportin e fundit të KOSTT, të datës 15 Prill 2015. KOSTT ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe mbetet i zotuar për të zgjidhur mosmarrëveshjen me EMS të Serbisë, veprimet e së cilës kanë bllokuar hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Lidhjes midis KOSTT dhe ENTSO-E. Në këtë kontekst gjendja vazhdon të jetë e njëjtë, si në datën e certifikimit.

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 9</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

12. Vonesa ose braktisja e investimeve të planifikuara

Sa i përket gjendjes së investimeve, për shkak të mos realizimit të planit investiv për vitin 2020, është konstatuar se Plani Investiv 2018-2022, ka nevojë për ndryshime me qëllim të përmbushjes së kërkesave për sigurinë e furnizimit, sigurinë kibernetike, kualitetin e furnizimit dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Arsyeshmëria për këto ndryshime paraqitet në vijim.

12.1 Arsyeshmëria për projektet e mos realizuara sipas Planit Investiv 2018-2022 (shtyrja e afatit të realizimit)

12.2 Mos realizimi i projekteve për shkak të vonesës në marrjen e lejeve, realizimit të shpronësimit dhe servitutit

a. Projekti (ID/006) "Linja e re 110 kV NS Rahovec- NS Theranda"

Ky projekt është në kuadër të projekteve të financuara nga BERZH (EBRD), i cili ka pas vonesa në marrjen e lejeve për ndërtim , shpronësim dhe servitut, prandaj projekti i paraparë për përfundim në vitin 2019 shtyhet deri në Q2 2020. Vlera e planifikuar e projektit 1,470 Mil €.

12.3 Grupi i projekteve që nuk kanë filluar me realizim për shkaqe të ndryshme dhe që realizimi bartet në vitet tjera të periudhës 2019-2022

a. Projekti (ID/049): NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/10(20) kV

Sqarim :

Në analizën rreth realizimit të shpenzimeve duhet të merret për bazë gjendja faktike se:

- KOSTT nuk ka Bord të Drejtorëve të emëruar që nga data 2 shtator 2018
- KOSTT nuk gjendet në situatë të paftësisë për të paguar – insolvencë
- KOSTT nuk gjendet në gjendje bankroti - qoftë të shpallur apo pa shpallur, apo procesi të likuidimit - qoftë vullnetar apo të dhunshëm
- Menaxhmenti i KOSTT ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë dhe në afat ligjor Planin e Biznesit dhe Buxhetin për vitin 2019
- Menaxhmenti i KOSTT në disa raste në mënyrë formale ka kërkuar nga Aksionari që të ndërmerren të gjitha masat për emërimin e Bordit të Drejtorëve, duke tërhequr vërejtjen për mungesën e miratimit të Buxhetit dhe Planit të Biznesit, por deri më sot KOSTT nuk ka Bord të Drejtorëve të emëruar.

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		Page 10
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

Duhet të rikujtohet se sipas Nenit 30 të Ligjit për ndërmarrjet publike Plani i Biznesit miratohet nga Bordi i Drejtorëve deri me 31 tetor të çdo viti kalendarik, për vitin e ardhshëm kalendarik. Plani i Biznesit duhet të analizojë së paku, si vijon:

- a) një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre;
- b) mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve;
- c) përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës për financimin e shpenzimeve;
- d) veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve; dhe
- e) detyrimet e NP karshi konsumatorëve dhe publikut.

Këto dispozita përshtatshëmrisht janë reflektuar edhe në Nenin 14.2.2, paragrafin 14.2.2.3, dhe 14.2.2.5 të Statutit të KOSTT, të cilat përcaktojnë se planet investive, planet financiare dhe Plani i Biznesit miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Pra, është e qartë se ekziston bazë e qartë ligjore sa i përket përgjegjësisë së miratimit të Planit të Biznesit, ndërsa në anën tjetër Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtë të përfaqësoj kompaninë dhe të lidh kontrata në bazë të autorizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve viz-a-viz Planit të Biznesit dhe Politikës për Nivelin e Autorizimit, sa i përket investimeve dhe shpenzimeve tjera.

Në rrethana normale, të një afarizmi të zakonshëm mungesa e miratimit të Planit të Biznesit dhe Buxhetit do të nënkuptonte mungesën e autorizimit për realizimin e shpenzimeve të caktuara, përveç atyre shpenzimeve të cilat paraqesin detyrime kontraktuale nga vitet e mëhershme, apo të cilat janë autorizuar në mënyrë të rregullt paraprakisht, apo edhe detyrimeve të kontratave të trashëguara nga vitet paraprake dhe kontratave të punës.

Në anën tjetër në mungesë të autorizimit të realizimit të shpenzimeve operative KOSTT do të duhej të ndërpresë disa apo të gjitha aktivitetet për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik (duke njohur ndërvarësinë e funksioneve operative, teknike, financiare dhe ligjore të operimit të KOSTT), pra operimit të sistemit elektro energjetikë dhe operimit të tregut të energjisë elektrike.

Kjo situatë, edhe pse përtej përgjegjësisë së vlerësimit ligjor apo këtij vlerësimi të kufizuar, me gjasë të madhe do të ishte në kundërshtim me detyrimet ligjore të ndërmarrjes dhe detyrimet e zyrtarëve të kompanisë, por më e rëndësishmja do të cenonte apo pamundësonte funksionimin e KOSTT dhe të gjithë funksioneve vitale publike në Kosovë, duke njohur funksionin monopolist të KOSTT.

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		Page 11
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

Sidoqoftë, edhe nëse KOSTT do të pezullonte disa apo të gjitha funksionet e operimit, duke urdhëruar punonjësit të pezullojnë apo ndërpresin punën deri në autorizimin e shpenzimeve operative në mënyrë të rregullt, KOSTT me gjasë të madhe do të detyrohej që pas rifillimit të operimit të kompensoj të gjitha pagat dhe shpenzimet operative, për shkak të kontratave të punës, dhe detyrimeve tjera kontraktuale-ligjore.

Ndërtimi i NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/35/10(20) kV me linjat transmetuese 110kV ; implementimi planifikohet 2020-2022

Projekt ndërtimi i NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/10(20) kV sipas planit investiv 2018-2022 është paraparë të fillon në vitin 2019 –2021. Nga stafi i KOSTT është përgatitur specifikimi teknik, por procedurat e prokurimit nuk janë realizuar në mungesë të aprovimit të buxhetit nga ana e Bordit të Drejtorëve. Projekti shtyhet për realizim në vitin 2020 – . Vlera e planifikuar e projektit 5.5Mil €.

Projektet e fazës së VI dhe VII - KfW

Sipas planit investiv ky grup i projekteve është planifikuar të finanohet me kredi nga KfW, përmes shërbimeve konsulentë të përgatitet specifikimi teknik në vitin 2019, dhe realizimi të bëhet gjatë vitit 2020-2022 por për shkak të mos arritjes së marrëveshjes së kredisë projekti shtyhet.

“Marrëveshja për kredi ndërmjet KOSTT dhe KfW për Fazën VI-VII është iniciuar qysh në vitin 2013, ndërsa fillimi formal i nismës për lidhjen e marrëveshjes për kredi është miratuar nga Qeveria e Kosovës me 08.09.2016 me Vendimin Nr. 03/108, ndërsa negociatat formale ndërmjet KOSTT, Ministrisë së Financave dhe KfW janë mbajtur me 13 dhe 14 nëntor 2017. Që nga Dhjetori 2017 për shkak të implikimeve politike në Kosovë si dhe obstrukcioneve nga Serbia për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT, vazhdimi i mëtejme i procedurave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kredi për Fazën VI-VII është pezulluar me kërkesë të palës gjermane/KfW, dhe atë deri në qartësimin e pozicionit të KOSTT për operimin e pavarur dhe futjen në operim të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. “

Ky Grup i projekteve shtyhet për periudhën e planifikuar në vitin 2020-2023. Vlera e planifikuar e projekteve faza VI 13.5 Mil € dhe faza e VII 12.00Mil € (pa shpronësim dhe servitut).

ID 053 Furnizim me 20 copë pajisje Meter Data Collection për nënstacionet distributive 110/x kV

	Raporti i i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Page 12</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

Projekti i paraparë për realizim në vitin 2019 shtyhet për vitin 2020

ID 055 Rehabilitimi i NS Prishtina 2 dhe NS Deqani (Ndërrimi i ndarësve 110kV)

Ky projekt planifikohet të realizohet gjatë vitit 2020 dhe për shkak të volumit të ndërrimit të pajisjeve vlera i rritet në 271,000€

13. Dividenda

Gjatë vitit 2019 nuk është deklaruar dhe as paguar ndonjë dividend nga ana e KOSTT gjegjësisht pas transferimit të së drejtës për të ushtruar të drejtat e aksionarëve në Kuvend, nuk ka pasur ndonjë kërkesë për të deklaruar ose paguar dividendë.

Për më shumë, përfaqësuesi i autorizuar i aksionarit nuk do të kishte fuqinë e njëanshme për të kërkuar dividend, pasi kjo do të kërkonte votim nga Deputetët e Kuvendit.

14. Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë

Marrë për bazë faktin se akoma nuk ka kaluar një vit i plotë që nga certifikimi i KOSTT-it si OST e rrjedhimisht edhe nga miratimi i emërimit të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë dhe Programit të Pajtuëshmërisë, raporti aktual përshkruan gjendjen bazuar në informacionet që kanë qenë e mundur të sigurohen përmes bashkëpunimit me strukturat përkatëse të OST-së por të cilat do të avancohen përmes themelimit të kanaleve adekuate të komunikimit duke synuar që të jenë sa më të plota me qëllim të zbatimit të çdo pike të Programit të Pajtuëshmërisë. Andaj, kjo pjesë e raportit synon të parashtroj veprimet të cilat është e nevojshme të ndërmerren me qëllim të sensibilizimit dhe ndërgjegjësimi të stafit të ndërmarrjes mbi çështjet e pajtuëshmërisë, nevojën e monitorimit të vazhdueshëm të pajtuëshmërisë dhe domosdoshmërinë e raportimit të çdo sjelljeje, veprimi apo komunikimi i cili qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme mund të cenoj pajtuëshmërinë.

Në mënyrë që të përmbushen detyrat dhe obligimet e zyrtarit të pajtuëshmërisë të cilat derivojnë nga programi i pajtuëshmërisë është e arsyeshme që të gjenden modalitete dhe lehtësira se si Zyrtari i Pajtuëshmërisë të mund të vihet në dijeni për çdo informacion të nevojshëm me qëllim të implementimit të Programit të Pajtuëshmërisë. Në këtë kontekst bazuar në paragrafin e fundit të Programit të Pajtuëshmërisë është e arsyeshme që në web faqen zyrtare të KOSTT-it të inkuadrohet rubrika ku do të publikohen të dhënat të cilat kanë të bëjnë me pajtuëshmërinë, të dhënat kontaktuese respektivisht

	Raporti i i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Faqe13</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

emaili zyrtar i Zyrtarit të Pajtueshmërisë, Programi i Pajtueshmërisë si dhe Raportet Vjetore të Pajtueshmërisë. Bazuar në pikën f) të Programit të Pajtueshmërisë pjesëmarrja e Zyrtarit të Pajtueshmërisë në takimet e KOSTT-it (të çfarëdo niveli) paraqet detyrim posaçërisht në temat e specifikuara shprehimisht me këtë pikë, e tëra kjo me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm të çështjes së pajtueshmërisë si dhe evitimit të cenimit apo shkeljes së saj.

Konkluzion

Bazuar në vlerësimin e kryer në lidhje me pajtueshmërinë mund të konstatohet se OST që nga certifikimi i saj me datë 15 shkurt 2019 ka bërë përpjekje të vazhdueshme në përmbushjen e obligimeve të marra përsipër me qëllim të sigurimit të shturjes pronësore respektivisht sigurimit të pavarësisë së OST-së, sigurimit të transparencës, evitimit të konfliktit të interesit, trajtimit të barabartë të përdoruesve të sistemit të transmetimit, qasjes jo diskriminuese për të gjithë përdoruesit në harmoni me kornizën ligjore e cila rregullon sektorin e energjisë. Sidoqoftë, bazuar në rekomandimet e lartpërmendura avancimi i mëtejshëm i formës së komunikimit respektivisht bashkëpunimit të stafit të ndërmarrjes me Zyrtarin e Pajtueshmërisë do të siguronte implementimin e plotë të Programit të Pajtueshmërisë.